Vendim nr. 318, datë 06.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 06.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 26 (Sh) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **Shoqëria "Fibernet" sh.p.k.,** e përfaqësuar nga avokatët Dritan Kruja dhe Korab Cani, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 6450 (80-2015-4572), datë 21.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 1435, datë 05.04.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-4425, datë 17.12.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, së drejtës për kontroll efektiv gjyqësor, lirisë ekonomike, së drejtës së pronës, parimit të proporcionalitetit, sigurisë juridike, lirisë së shprehjes dhe komunikimit dhe së drejtës për mjet juridik efektiv.
Kthimi i çështjes për rishqyrtim në përputhje me standardet kushtetuese dhe konvencionale. Marrja e çdo mase tjetër të nevojshme për rivendosjen e rendit kushtetues dhe mbrojtjen efektive të të drejtave themelore.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 5, 11, 15, 41, 42, 131, pika 1 shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; Konventa Evropiane për të Drejtat**

e Njeriut *(KEDNJ)*, neni 1, Protokolli 1 i saj;*;* ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës).*

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është person juridik, me ortak të vetëm dhe njëkohësisht administrator shtetasin A.Gj. Kërkuesja është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit *(QKB)*, sot Qendra Kombëtare e Biznesit në datën 18.01.2012 në formën e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin ekskluziv të veprimtarisë radiotelevizive, operator transmetimi, televizion kabllor, shërbim interneti, shërbim telefonie, import-eksport materialesh të ndryshme etj.

2. Grupi i inspektorëve të Autoritetit të Mediave Audiovizive *(AMA)*, në zbatim të urdhrit nr. 281, datë 01.09.2015 të kryetarit të AMA-s, në datën 01.09.2015 ka kryer kontrollin e veprimtarisë së kërkueses në prani të administratorit të saj. Gjatë kontrollit, në lidhje me shërbimet e transmetimit audioviziv që ofroheshin, inspektorët kanë konstatuar se ishin pa autorizim nga AMA. Ndërsa sipas përfaqësuesit të kërkueses, shërbimi ofrohej nga një shoqëri tjetër, "S.D." sh.p.k., që kishte autorizim nga AMA, por ishte me aktivitet të pezulluar. Në përfundim të kontrollit, grupi i inspektorëve ka konstatuar shkeljen nga kërkuesja të dispozitave të ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 97/2013)*, si rrjedhojë e ofrimit të shërbimeve audiovizive përmes paketës televizive pa autorizim të AMA-s. Për këtë shkak, bazuar në nenet 132, pika 1, e 133, pika 5, të këtij ligji, me vendimin nr. 28, datë 01.09.2015 të inspektorëve të AMA-s, kërkuesja është ndëshkuar me gjobë në masën 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë, si dhe i është kërkuar të ndërpresë menjëherë transmetimet.

3. Ndërsa me urdhrin nr. 283 të datës 03.09.2015 *(urdhri nr. 283/2015)* të kryetarit të AMA-s është urdhëruar marrja e masës për bllokimin, inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura nga kërkuesja. Në bazë të këtij urdhri, me vendimin nr. 1, datë 03.09.2015 *(vendimi nr. 1/2015)*, inspektorët e AMA-s kanë vendosur bllokimin, inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura nga kërkuesja për ushtrimin e

veprimtarisë së transmetimit audioviziv pa autorizim nga AMA, proces ky i cili është realizuar në datën 23.09.2015 kur edhe kanë mbajtur procesverbalet përkatëse për këtë qëllim. Ndaj vendimit për sekuestrimin mund të paraqitej ankim në gjykatë brenda 10 ditëve (pika 3 e nenit 80 të ligjit nr. 97/2013 e parashikuar në pikën 2 të vendimit nr. 1/2015). Pas kalimit të afatit të ankimit dhe në rast se pas ankimit gjykata e vlerëson të ligjshëm sekuestrimin, pajisjet e bllokuara konfiskohen dhe kalojnë në pronësi të shtetit (pika 4 e nenit 80 të ligjit nr. 97/2013 e parashikuar në pikën 3 të vendimit nr. 1/2015).

4. Grupi i inspektimit është paraqitur në ambientet e kërkueses, me qëllim ekzekutimin e urdhrit nr. 283/2015 dhe vendimit nr. 1/2015, ku është mbajtur edhe procesverbali i datës 03.09.2015. Në vijim, me qëllim ekzekutimin e akteve, inspektorët i janë drejtuar për bashkëpunim edhe organeve të Policisë së Shtetit. Në datën 23.09.2015 është bërë ekzekutimi i akteve për bllokimin, inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura nga kërkuesja për ushtrimin e veprimtarisë së transmetimeve audiovizive pa autorizim nga AMA duke u përpiluar edhe procesverbali i bllokimit dhe sekuestrimit të pajisjeve (kryesisht dekoder dhe converter).

5. Kërkuesja në datën 04.09.2015 ndaj sanksionit me gjobë ka paraqitur ankim administrativ në AMA. Me vendimin nr. 85, datë 26.10.2015, AMA ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankimit duke reduktuar masën e gjobës nga 10.000.000 lekë në 5.000.000 lekë. Kërkuesja e ka kundërshtuar gjobën në gjykatat administrative dhe me vendimin gjyqësor të formës së prerë është vendosur rrëzimi i padisë, për rrjedhojë lënia e fuqi e masës së gjobës prej 5.000.000 lekësh. Në datën 24.10.2025 kërkuesja i është drejtuar edhe Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual duke kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna gjatë procesit gjyqësor për kundërshtimin e masës së gjobës, po ashtu urdhrin nr. 283/2015 edhe vendimin nr. 1/2015 për sekuestrimin e pajisjeve. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 44, datë 04.02.2026, në lidhje me aktet për sekuestrimin e pajisjeve, ka vlerësuar se kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive, ndërsa për sa u përket pretendimeve për procesin gjyqësor në lidhje me vendosjen e masës së gjobës i ka vlerësuar ato haptazi të pabazuara.

6. Në datën 08.09.2015 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, me objekt anulimin për pavlefshmëri relative: i) të urdhrit nr. 283/2015 (nr. 666 protokolli) "Për bllokimin, inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura nga shoqëria "Fibernet" sh.p.k.., për ushtrimin e veprimtarisë së transmetimeve audiovizive pa autorizimin nga AMA"; ii) të vendimit nr. 1/2015, të grupit të inspektorëve të AMA-s, me objekt: "Për bllokimin, inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura

nga shoqëria “Fibernet” sh.p.k., për ushtrimin e veprimtarisë së transmetimeve audiovizive pa autorizimin nga AMA”.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6450 (80-2015-4572), datë 21.12.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar se vendimi i kundërshtuar nuk është përfundimtar sipas parashikimit të nenit 46 të ligjit nr. 10433/2011“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” *(ligji nr. 10433/2011),* por është vetëm një masë e përkohshme, urgjente deri në daljen e një vendimi përfundimtar dhe AMA ka pasur detyrimin për të marrë vendimin për dënimin ose jo të kërkueses brenda 30 ditëve nga kryerja e kontrollit. Masa urgjente është marrë në datën 03.09.2015 dhe ka pasur afat deri në datën 03.10.2015. Sipas gjykatës së shkallës së parë, aktet administrative të kundërshtuara, si masa urgjente, janë nxjerrë në përputhje me ligjin, pasi kërkuesja nuk ka autorizim ose licencë të lëshuar nga AMA për ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizive. Gjithashtu, sipas asaj gjykate, nga verifikimi i regjistrit të sipërmarrësve që kanë njoftuar ofrimin e mjeteve të komunikimeve elektronike për transmetim audio dhe/ose audioviziv sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm deri në datën 26.08.2015, pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), kërkuesja është e paregjistruar, pra nuk ka njoftuar as AKEP-in për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike për transmetimin audio dhe/ose audiovizive sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm.

8. Pas ankimit të kërkueses, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1435 datë 05.04.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 6450 (80-2015-4572), datë 21.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar në të njëjtën linjë si gjykata e shkallës së parë se inspektorët kanë vepruar në përputhje me ligjin, pasi kërkuesja nuk është e autorizuar për ofrimin e shërbimeve. Edhe sipas gjykatës se apelit, vendimi nr. 1/2015 është një masë urgjente sekuestrimi i pajisjeve të transmetimit e marrë deri në daljen nga organi kompetent me një vendim përfundimtar lidhur me një kundërvajtje administrative. Gjithashtu, inspektorët e AMA-s duhet të kishin vepruar brenda afatit 30-ditor të parashikuar nga neni 46 i ligjit nr. 10433/2011 për të marrë një vendim përfundimtar për konfiskimin ose zhbllokimin e pajisjeve të sekuestruara në lidhje me inspektimin e realizuar pranë shoqërisë.

9. Ndaj vendimit kërkuesja, në datën 11.07.2018, ka ushtuar rekurs duke pretenduar cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar, respektimin e parimit të proporcionalitetit, respektimin e së drejtës së pronës, sepse pajisjet janë konfiskuar pa pasur një vendim konfiskimi, si dhe ka pretenduar ndalimin e diskriminimit, sepse vendimet e marra ndaj saj kanë bërë që ajo si kompani të dalë jashtë tregut të lirë kur ka edhe shumë kompani të tjera që kryejnë të njëjtën veprimtari si ajo. Ndërsa në datën 11.12.2025 kërkuesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë

parashtrime, ku ka ngritur edhe pretendime për cenimin e lirisë së shprehjes, shtypit dhe mjeteve të informimit e lirinë ekonomike. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-4425, datë 17.12.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbushen kërkesat e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012)*.

10. Kërkuesja, në datën 13.05.2026 nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, sipas objektit. Kërkesa është regjistruar në datën 05.06.2026, pas plotësimit të dokumentacionit përkatës. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkueses

11. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesi gjyqësor i është cenuar:

11.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor dhe e drejta për akses efektiv,* pasi procesi gjyqësor ka mbetur në një kontroll formal të ligjshmërisë, pa realizuar një kontroll real, efektiv dhe substancial për ndërhyrjen e administratës. Gjykatat e zakonshme kishin detyrimin të shqyrtonin në mënyrë konkrete nëse masa administrative ishte faktikisht dhe teknikisht e justifikuar, e nevojshme dhe proporcionale. Gjykatat nuk kanë kryer verifikim të plotë për natyrën reale të aktivitetit të ushtruar, parametrat konkretë të transmetimit, natyrën dhe funksionin e infrastrukturës teknologjike të përdorur, funksionin teknik të pajisjeve të sekuestruara, lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet pajisjeve dhe aktivitetit të pretenduar si të paligjshëm, si dhe elementet teknike që do të mundësonin klasifikimin e veprimtarisë së kërkueses si transmetim audioviziv subjekt autorizimi. Ndërhyrja administrative mori karakter ndëshkues dhe kufizues me intensitet të lartë, duke afruar efektet e saj praktike me masa me natyrë represive, pa u shoqëruar me standarde procedurale dhe me garanci kushtetuese. Mungesa e një verifikimi teknik dhe e një baze të plotë provuese ka bërë që gjykatat të pranojnë konstatimet arbitrare të administratës pa një kontroll të pavarur e substancial, duke krijuar një prezumim në favor të administratës publike, gjë që konsiderohet në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë kuptim, mungesa e një kontrolli substancial mbi ligjshmërinë

reale të ndërhyrjes, proporcionalitetin e masës dhe pasojat konkrete mbi të drejtat themelore të kërkueses kanë cenuar të drejtën e aksesit sipas standardeve kushtetuese dhe nenit 13 të KEDNJ-së.

11.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata Administrative e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë pa zhvilluar një analizë autonome dhe substanciale të pretendimeve të kërkueses. Gjykata Administrative e Apelit nuk ka trajtuar në mënyrë efektive pretendimet lidhur me mungesën e provave të specializuara teknike, mungesën e alternativave më pak kufizuese tejkalimin e kompetencave dhe cenimin e të drejtave të kërkueses, si subjekt tregtar. Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar për shkaqet e rekursit, të cilat lidhen me kufijtë e ndërhyrjes së administratës dhe mbrojtjen e së drejtës së pronës dhe të lirisë së veprimtarisë ekonomike.

11.3. *Liria e veprimtarisë ekonomike dhe e drejta e pronës*, të garantuara nga nenet 11 dhe 41 të Kushtetutës, pasi masa për sekuestrimin dhe bllokimin e pajisjeve ka cenuar të drejtën e pronës, si dhe ka kufizuar përdorimin funksional dhe ekonomik të pasurisë. Ndërhyrja në pronë duhet të ketë bazë ligjore, të ndjekë interes publik legjitim dhe të ruajë një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe barrës së imponuar subjektit privat. Bllokimi dhe sekuestrimi i pajisjeve nuk ka prekur vetëm posedimin fizik të tyre, por ka ndikuar drejtpërdrejt në mundësinë funksionale dhe ekonomike për të ushtruar aktivitetin tregtar. Pajisjet dhe infrastruktura teknologjike paraqiten si elemente funksionale thelbësore të aktivitetit ekonomik të shoqërisë. Në respektim edhe të *parimit të proporcionalitetit*, çdo kufizim duhet të jetë i parashikuar nga ligji, të ndjekë një interes publik dhe të jetë i domosdoshëm. Gjykatat nuk kanë analizuar nevojën reale për një masë kaq intensive/përshtatshmërinë e masës, pamundësinë e përdorimit të masave më të buta, domosdoshmërinë konkrete dhe balancimin ndërmjet interesit publik dhe të drejtave themelore të kërkueses.

11.4. *Liria e shprehjes dhe liria e komunikimit*, pasi ndërhyrja administrative nuk ka sjellë pasoja vetëm në aktivitetin ekonomik dhe në përdorimin e pasurisë teknike, por ka ndikuar edhe në komunikimin elektronik, shpërndarjen e informacionit vijimësinë funksionale të aktivitetit tregtar. Sekuestrimi dhe bllokimi i pajisjeve teknike të përdorura për transmetim dhe komunikim përbën ndërhyrje që prek jo vetëm interesat pasurorë të subjektit tregtar, por potencialisht edhe ushtrimin efektiv të lirisë së komunikimit dhe lirisë së shprehjes, në kuptim të nenit 22 të Kushtetutës dhe nenit 10 të KEDNJ-së. Administrata dhe gjykatat e zakonshme nuk

kanë analizuar ndikimin e masës mbi komunikimin elektronik, efektet kufizuese të sekuestrimit për shpërndarjen e informacionit, proporcionalitetin e ndërhyrjes në raport me lirinë e komunikimit dhe ekzistencën e alternativave më pak kufizuese.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

12. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Duke verifikuar plotësimin e këtyre kritereve, në rastin konkret Kolegji vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae,* pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor objekt kundërshtimi, ndaj kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

14. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Ky kriter nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural *(shih vendimet nr. 28, datë 30.04.2025; nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 38, datë 12.07.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

15. Kolegji vëren se kërkuesja në ankimin kushtetues individual mes të tjerave ka parashtruar pretendime për *cenimin e lirisë së shprehjes dhe të lirisë së komunikimit*. Nga përmbajtja e akteve bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuesja pretendimet për *cenimin e lirisë së shprehjes e të lirisë së komunikimit* nuk i ka ngritur në rekursin e ushtruar në

Gjykatën e Lartë në datën 11.07.2018, por vetëm në parashtrimet e depozituara në atë gjykatë (Gjykatën e Lartë) në datën 11.12.2025. Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë rezulton se nuk është pasqyruar fakti i paraqitjes së parashtrimeve, për rrjedhojë edhe argumentet e ngritura në të. Në kushtet kur Gjykata e Lartë shqyrton rekursin brenda kufijve të tij dhe këto pretendime nuk janë shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, ato nuk mund të merren në shqyrtim nga kjo Gjykatë, pasi konsiderohet se në lidhje me to kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive *(shih vendimin nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese).*

16. Për pretendimet e tjera, që në thelb lidhen me vendimmarrjen e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, proporcionalitetin e masës së vendosur ndaj saj dhe faktin që sekuestrimi i pajisjeve në pronësi të kërkueses ka ndikuar në vazhdimësinë e veprimtarisë së saj, kërkuesja i ka paraqitur në substancë përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndaj plotëson kriterin për shterimin e mjeteve juridike efektive.

17. Gjithashtu, kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është depozituar në Gjykatë në datën 13.05.2026 nëpërmjet shërbimit postar, kurse vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë në datën 17.12.2025, por është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në datën 13.01.2026, për rrjedhojë kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

18. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së *drejtës për proces të rregullt ligjor dhe aksesit efektiv, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe së drejtës së pronës.* Në thelb të pretendimeve kërkuesja ka parashtruar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk i kanë dhënë përgjigje kërkimit nëse ndërhyrja e administratës së AMA-s për bllokimin dhe sekuestrimin e pajisjeve ka qenë proporcionale ose jo. Si pasojë e qëndrimit të gjykatave të zakonshme kërkueses i është cenuar edhe e drejta e pronës. Duke mbajtur në konsideratë se pretendimet e kërkueses lidhen me vendimmarrjen e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe me qëndrimin e tyre ndaj sekuestrimit të pajisjeve në pronësi të kërkueses, duke e lidhur cenimin e së drejtës së pronësisë dhe të lirisë së veprimtarisë ekonomike me procesin e rregullt, ato do të analizohen së bashku *në drejtim aksesit substancial në gjykatë dhe të së drejtës së pronës e të lirisë së veprimtarisë ekonomike të lidhura me standardin arsyetimit të vendimit gjyqësor* nëse zbatimi i ligjit ka elemente arbitrariteti.

19. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e saj, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Ndërsa po sipas nenit 42 të Kushtetutës, e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të

shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, përpara së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit *(shih vendimet nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se, mes të tjerave, liria e veprimtarisë ekonomike, e garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, nënkupton kryesisht të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe shërbimeve (*shih vendimet nr. 28, datë 27.05.2010; nr. 10, datë 19.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata është shprehur gjithashtu se liria e veprimtarisë ekonomike përmban edhe detyrimin e shtetit që, nëpërmjet ligjvënësit, të ndërhyjë në rregullimin e kësaj lirie, me qëllim që të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i së mirës së përbashkët. Detyrimi për rregullim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë ose fusha të caktuara. Kufizimet e lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj, për arsye të rëndësishme publike dhe duke respektuar parimin e proporcionalitetit *(shih vendimet nr. 32, datë 27.10.2021; nr. 14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë *(shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

22. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e saj është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit për proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e

çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave *(shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese).*

23. Pa rënë në përsëritje të fakteve *(shih paragrafët 1-9 të vendimit),* Kolegji, në mënyrë të përmbledhur, vëren se çështja lidhet me kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ndaj masës së marrë nga AMA për kërkuesen, konkretisht me bllokimin, inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura nga shoqëria, për shkak se gjatë kontrollit është konstatuar se ajo ushtronte veprimtari transmetimi audioviziv pa autorizimin përkatës. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin nr. 6450 (80-2015-4572), datë 21.12.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë duke e bazuar arsyetimin në dy momente kryesore: a) vendimet/aktet e kundërshtuara nuk janë përfundimtare, ato kanë efekt të përkohshëm, sepse në bazë të nenit 80 të ligjit nr. 97/2013 dhe nenit 46 të ligjit nr. 10433/2011 autoriteti përkatës duhet të merrte vendim përfundimtar; b) aktet e kundërshtuara janë marrë në zbatim të ligjit specifik. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1435, datë 05.04.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë me të njëjtën linjë arsyetimi. Ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-4425, datë 17.12.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit.

24. Kolegji vëren se kërkuesja nuk ka paraqitur pretendime për papajtueshmërinë e ligjit të zbatueshëm në rastin konkret me Kushtetutën, por pretendimet e saj janë të lidhura me vendimet gjyqësore të dhëna nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se nga vendimet e kundërshtuara nuk konstatohet që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arritur në përfundime arbitrare ose haptazi të paarsyeshme, në kuptimin kushtetues të këtyre koncepteve. Vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor gjykatat e zakonshme kanë dhënë një vendim jo në favor të kërkueses, si dhe fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të saj, nuk mjaftojnë për të vënë në dyshim rregullsinë kushtetuese të procesit gjyqësor të kundërshtuar. Në thelb, argumentet e kërkueses synojnë të vënë në diskutim mënyrën sesi gjykatat e zakonshme kanë vlerësuar faktet dhe provat dhe kanë interpretuar dispozitat e ligjeve specifike në funksion të zgjidhjes së çështjes në themel. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zbatuar rregullimet ligjore, që parashikojnë rastin kur subjekti ka kryer veprimtari në fushën e transmetimeve pa marrë licencë nga AMA. Në këtë rast parashikohet në mënyrë të shprehur se subjektit i sekuestrohen pajisjet (neni 80 i ligjit nr. 97/2013). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm në lidhje me zbatimin e ligjit për masën e sekuestros së pajisjeve nuk rezulton të

ketë qenë arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm duke mos sjellë as *cenimin e lirisë se veprimtarisë ekonomike dhe së drejtës së pronës,* ndaj pretendimet e kërkueses janë haptazi të pabazuara.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat "d" dhe "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.